



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

Procesverbal
Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Dimal

Mbajtur më datë 27.09.2023

Ora e hapjes së mbledhjes 14:00, vendi i mbajtjes së mbledhjes në Njësinë Administrative Poshnje kati i I-rë salla e mbledhjeve e Këshillit të Bashkisë Dimal. Mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Dimal e hapur.

Në mbledhje janë të pranishëm përfaqësues të administratës të cilët kanë hartuar projekt vendimet që do të merren në shqyrtim.

Kryetari i Këshillit deklaroj hapjen e mbledhjes.

Sh.Tafa : Kërkoj fjalën duke relatuar sipas materialit të tij mbi kompetencat e komisioneve të përhershme për zhvillimin e mbledhjes. Ai shprehet se Komisionet e përhershme duhet të ishin mbledhur para mbledhjes së këshillit sepse kështu e përmban rregullorja duke i referuar neneve të ligjit dhe rregullores. Më pas fjalën e mori B. Dhëmbi i cili ngriti problem e mosmarrjes së njoftimit në kohë , problem i cili u adresua nga Sekretarja e Këshillit e cila referoi me fakte orë dhe vendin e dërgimit.

H.Hoxha: Njoftimi është bërë në datën 22.09.2023 dhe është në kohë, pasi ligji e përcakton 5 ditë kalendarike jo ditë pune dhe për sa i përket mbledhjes së komisioneve ajo duhet të ishte iniciuar nga vet ne.

Kryetarja e Bashkisë: Kemi zbatuar ligjin në afat për dërgimin e materialeve dhe Komisionet e Përhershme duhet të mblidhen nga ju nuk i inicion Bashkia.

Këshilltarët e grupit largohen nga salla e mbledhjeve.

A.Salillari: hidhet në votim rendi i ditës dhe miratohet me 13 Vota pro nga 13 këshilltarë prezentë.

A. Salillari : hidhet në votim miratimi i procesverbaleve dhe miratohet me 13 Vota pro nga 13 këshilltarë prezentë.

Pika 3 e rendit të ditës: Mbi miratimin e projekt-vendimit nga fondi i kushtëzuar 6%. Në mbështetje të ligjit Nr.9355 datë 10.03.2005 “ Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore “ i ndryshuar , VKM nr.955 datë 7.12.2016 “ Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” . Sektori i Ndihmës Ekonomike propozon për muajin Gusht 2023 për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% referuar nga sistemi 3 familje me fond 27.918 lekë. Familjet janë përzgjedhur nga administratorët duke u bazuar në kriterë.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 13 Vota pro nga 13 këshilltar prezentë.

Pika 4 e rendit të ditës: Mbi miratimin e projekt-vendimit “ Trajtimi me ndihmë ekonomike sipas listës emërore bashkëlidhur për 105 familje nga fondet e Bashkisë në shumën 244.000 lekë për muajin Gusht 2023.

M.Tomani: Përfaqësuesi i Drejtorisë së Shërbimit Social, Ndihmës Ekonomike dhe PAK filloi të referonte dhe projekt-vendimin e paraqitur. Familjet janë përzgjedhur nga administratorët e Njësive Përkatese duke u bazuar në kriterë të miratuar me Vendim Këshili si dhe duke bërë verifikimëe përkatëse. Në mbështetje të ligjit 9355 daë 10.03.2005 “Për ndihmë dhe shërbimet shoqërore “ i ndryshuar si dhe VKM nr. 955 datë 07.12.2016 “ Për përcaktimin e kriterëve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” VKB nr.84 datë 27.12.2022 “ Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 si dhe ligjit për “Vetëqeverisjen Vendore”, Sektori i ndihmës Ekonomike propozon 105 familje për muajin Gusht.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 13 Vota pro nga 13 këshilltarë prezentë.

Pika 5 e rendit të ditës: Mbi miratimin e projekt-vendimit për miratimin e vlerës së mbikëqyrjes për disa objekte dhe burimi i mbulimit për vitin 2023.

G.Bolani: Drejtoria e Planifikimit dhe Territorit filloi të referonte për relacionin dhe projekt vendimin e paraqitur. Kemi përfunduar procedurën për disa objekte dhe për tu miratuar vlera duhet të kalohet në Këshill.

Sipas ligjit për supervizimet dhe kolaudimet dhe lind nevoja për parashikimin në buxhet, dhe vlerës përkatëse sipas kalkulimeve të bërë nga drejtoria përkatëse.

Ndaj kërkohmë që për vijimin e punës, kërkohmë miratimin tuaj. Edhe shkolla e Goricanit për shkak të problematikës që ka pasur, ka vlerën përkatëse të supervizimit që të vijojmë nga puna. Të gjitha këto investime janë në kuadër të përmbjlljes së tyre si dhe në lidhjen e kontratës përkatës të tyre.

B.Goga: Shkolla e Goricanit

Kryetarja e Bashkisë: Këtë vit fillojnë punimet afati dhe financimet është dhënë nga buxheti i shtetit dhe po mbyllen të gjitha fazat e prokurimit publik.

A.Salillari: Miratohet me 13 Vota pro nga 13 Këshillatë të prezentë.

Pika 6 e rendit të ditës: Mbi miratimin e projekt-vendimit dhe relacionin e paraqitur për zgjerimin e varrezave Poshnje, sipas VKM-së nr.711 datë 29.10.2014 “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë pas diskutimeve dhe verifikimeve në terren situata është shumë problematike dhe ka nevojë për zgjidhje emergjente, pasi u pa e arsyeshme zgjerimi i varrezave ekzistuese.

Zgjerimi i varrezave do të bëhet duke plotësuar kushtet dhe rregullat teknike që parashikon VKM Nr.711 datë 29.10.2014 “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë “. Varrezat ekzistuese ndodhen në pasurinë 7/1 zk 3032 po dhe zgjerimi i tyre do të bëhet në varrezat ekzistuese , po në parcelën me nr pasurie 7/1 zk 3032 e cila është pronë shtetërore. Sipërfaqja e varrezës së zgjeruar do të jetë 3000m².

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro nga 13 këshilltarë të prezentë.

Pika 7 e rendit të ditës: Mbi miratimin e projekt-vendimit: “ Mbi miratimin e prishjes (mbylljes) së shoqërisë aksionare “FK Osumi” Sh.A”.

A.Kora : Po ju paraqesim materialin për mbylljen e shoqërisë aksionare “FK OSUMI”dhe krijimin e shoqatës me antarësi, kjo shoqëri aksionere nuk ka funksionuar dhe nuk kemi shpenzuar asnjë lekë për të.

Fakti që organizohet si shoqatë është se ka më pak kosto për Bashkinë dhe në uadër të vijimit të funksionimit të kësaj federate mendojmë që të rregjistrohet si shoqatë me antarësi në gjykatë.

G. Hazizolli: A ka funksionuar kjo si shoqëri aksionere?

Kryetarja e Bashkisë: Po e rithem se kjo shoqëri nuk ka funksionuar.

A.Kora: Për samë sipër kërkohet aprovimi juaj për miratimin e kësaj shoqate të re, e cila do të jetë një organizatë jofitimprurëse dhe duhet të miratohet dhe akti i themelimit dhe statuti i kesaj shoqate për mbarëvajtjen normale të procesit të punës si dhe duhet të miratohet logo zyrtare e kësaj shoqate e cila do të jetë element dallues për këtë.

A.Salillari : Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro nga 13 keshilltarë të prezentë.

Pika 8 e rendit të ditës: Mbi miratimin e projekt-vendimit “ Për miratimin e vlerës e qirasë së ambienteve private të cilat do të funksionojnë si kopësht/ shkollë për tu përdorur për nevoja të Bashkisë Dimal.

R.Hoxha: Si cdo vit Sektori i Arsimit Kulturës dhe Sporteve miraton vlerën e qirasë të cilat do të funksionojnë si kopësht/shkollë për nevoja të Bashkisë Dimal.

Sipas verifikimeve të kryera në lidhje me mirëfunksionimin e godinave, rezulton se kushtet në këto ambiente janë shumë të mira, godinat janë të përshtatshme për mësimdhënie.

Pagesat e qirasë për objektet e marra me qera për arsimimin dhe për funksionimin me uji janë të parashikuara në programin buxhetor afatmesëm 2023-2025. Kontrata e qirasë do të lidhen me nje afat 1 vjecar nga momenti i lidhjes së kontratës me subjektn qiradhënës. Për këtë arsye kërkojmë miratimin nga ana juaj për vlerën e qirasë së ambienteve.

A.Salillari: Hidhet në votim dhe miratohet me 13 Vota pro nga 13 keshilltarë prezentë.

Pika 9 e rendit të ditës: Informacion mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën 8 mujore Janar 2023- Gusht 2023.

M.Bizdani: Po ju paraqesim informacionin mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit për peridhën Janar- 31 Gusht 2023. Në këtë informacion kemi të përmbledhur programet buxhetore që monitorohen nga drejtuesit e programeve buxhetore. Cdo program ka treguesit e vet si dhe bashkëlidhur kemi situacionin e shpenzimeve buxhetore për cdo program buxhetor , si dhe investimet për periudhën Janar-Gusht 2023. Nëpërmjet këtij materiali synohet likuidimi i detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga viti 2022 si dhe shpenzimet koherente.

Synimi ynë është minimizimi i borxhit të trashëguar duke ulur shpenzimet si dhe të kryhen ato investime të cilat janë prioritare për komunitetin. Të gjithë bashkë do punojmë për uljen e borxhit duke punuar me përkushtim për këtë.

M.Bizdani: Është një informacion nuk ka nevojë për vendimarrje.

Pika 10 e rendit të ditës: Raporti i Performancës 2022 për Qytetarin.

R.Shuka: Informacioni që po referoj është hartuar në bashkëpunim me projektin Bashki të Forta dhe është i përbërë nga indikatorët e performancës 2022, informacion i cili do të bëhet transparent për qytetarin. Nëpërmjet këtij informacioni qytetari të ketë infomacion mbi burimet e të arrdhurave dhe mënyrën e shpenzimet e tyre. Është një informacion nuk ka nevojë për vendimarrje.

Pika 11 e rendit të ditës: Informacion i Përgjithshëm mbi ndryshimet klimatike në Bashkinë Dimal.

A.Allabej: Sektori i Mjedisit ka paraqitur një informacion të përgjithshëm mbi ndryshimet klimatike dhe po j'ua prezantojmë. Klima është gjendja mesatare e motit në një vend të caktuar. Moti është gjendja e atmosferës e cila përcaktohet nga disa dukuri si reshje temperatura etj.

Ndryshimet klimatike janë zhvendosjet e kësaj gjendje mesatare shumëvjeçare të motit, pra ndryshimet klimatike janë gjendje mesatare shumëvjeçare të motit. Ajo që po ndikon më së shumti në ndryshimin e klimës është akteviteti njerëzor nga veprimet e pakontrolluara si diegja e qymyrit, gazit, shpyllëzimi.

Efekti serë në prani të disa gazave si dhe dioksidi i karbonit dhe gazi metan pengojnë shpërndarjen e nxehtësisë përtej tokës në gjithësi. Ky proces është njohur si efekti serë. Menaxhimi i mbetjeve nënkupton grumbullimin e mbetjeve të ngurta nga pikat e grumbullimit të mbetjeve shpërndarë në funksion të dendësisë së popullatës dhe aktiviteteve private e shtetërore. Menaxhimi i mbetjeve ka 5 lloje ndikimesh që i atribuohen. Bashkia Dimal në mbështetje të qeverisë zviceriane ka qënë ndër Bashkitë e para që zbatoi projektin e menaxhimit të mbetjeve në rang qarku.

B.Bani: Kisha një vërejtje, në lidhje me mbetjet që duhet ti pastrojmë më shpesh këto mbetje.

Kryetarja e Bashkisë: Patjetër do ta kemi në konsideratë një përmisim në cilësinë e shërbimit.